

VENDIM
Nr. 681, datë 2.9.2020

PËR MËNYRËN E KRIJIMIT, TË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË (AKR)

(Ndryshuar me Vendimin nr. 99, datë 11.2.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”; dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë (në vijim AKR), si person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rininë, me seli në Tiranë.

2. AKR-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

3. Misioni i AKR-së është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

4. AKR-ja e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie:

- a) mbështetjen për edukim joformal;
- b) ndërveprimin dhe aktivizmin e rinisë;
- c) financimin e veprimtarive rinore.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AKR-së

1. AKR-ja ka përgjegjësi të organizojë veprimtarinë për:

a) realizimin e funksioneve që lidhen me mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve;

b) sigurimin e kushteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e të rinjve nga subjekte vendase ose të huaja;

c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut të strukturuar, për përfshirjen e sa më shumë palëve, me synim fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri;

ç) krijimin e mekanizmave për zhvillimin dhe nxitjen e politikave rinore, si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti i shtetit.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AKR-së

1. AKR-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. AKR-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton veprimtarinë e institucionit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët. Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet para ministrit përgjegjës për rininë. Drejtori emërohet në detyrë dhe lirohet nga ministri përgjegjës për rininë.

3. Struktura dhe organika e AKR-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

4. AKR-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

- a) zbaton politikat dhe programet për të rinjtë;

b) planifikon, zbaton dhe raporton mbi shpenzimin e fondeve të akorduara nga ministria përgjegjëse për rininë dhe fondeve të tjera të siguruara;

c) harton dhe konsulton me Këshillin Kombëtar të Rinisë e grupet e interesit programin vjetor të financimit dhe skemën e shpërndarjes së pjesës së fondit grant, të dedikuar për rininë, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore;

ç) propozon për miratim te ministria përgjegjëse për rininë programin vjetor të financimit dhe skemën e shpërndarjes së pjesës së fondit grant, të dedikuar për rininë, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore;

d) harton, miraton dhe publikon thirrjet për projektpropozime drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, *bashkive dhe grupeve joformale rinore*;

d/1) Zbaton programin e talentëve rinore, publikon dhe promovon thirrjet për aplikim, menaxhon procesin e përzgjedhjes dhe akordon mbështetjen financiare për të rinjtë, përfitues në program;

dh) ndjek dhe zhvillon veprimtari rinore, kulturore, artistike, letrare, sportive, të mbrojtjes së mjedisit dhe edukimin joformal, si dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për rininë;

e) organizon takime, konferenca, fushata ndërgjegjësuere për përfshirjen e rinisë në jetën sociale, punësim e vendimmarrje;

ë) jep informacion ndaj të rinjve *dhe grupeve joformale rinore* dhe/ose organizatave rinore për thirrjet për aplikime në projekte rinore të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë dhe atyre ndërkombëtare;

f) ofron trajnime teknike për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë *dhe grupet joformale rinore*, për aplikim për projekte ndërkombëtare;

g) jep certifikatat e vlerësimit për pjesëmarrje të të rinjve në kurse trajnimi dhe veprimtari rinore;

gj) ofron shërbimin e ngritjes së kapaciteteve rinore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;

h) ofron shërbime të ndryshme komunitare, nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve, për përmirësimin e jetës shoqërore në komunitetet e tyre;

i) hyn në marrëdhënie kontraktore me çdo organizatë rinore dhe/ose për të rinjtë, vendase apo të huaj, *individ dhe grup joformal rinor*, që financon apo financohet;

j) monitoron zbatimin e projekteve *dhe programeve për të rinjtë*, që kanë përfituar mbështetje financiare;

k) bashkëpunon me organizma, institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase dhe të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore;

l) mbështet ngritjen e kapaciteteve të njësive dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor për edukimin, ndërveprimin dhe aktivizmin e të rinjve;

ll) krijon, administron dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë, si dhe realizon ndërveprimin e bazës së të dhënave me bazat e tjera të informacionit, sipas legjislacionit në fuqi;

m) siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat transferohen mbi bazë vjetore, në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar;

n) mbledh, administron dhe analizon të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;

nj) raporton, në mënyrë periodike, pranë ministrisë përgjegjëse për rininë, për situatën e të rinjve;

o) mbikëqyr veprimtarinë rinore dhe të punës me të rinjtë nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë *dhe grupet joformale rinore*, që përfitojnë mbështetje nga fondi grant i dedikuar për rininë, nga buxheti i shtetit;

o/1) Mbulon shpenzimet e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR);

o/2) Mbulon shpenzimet për trajtimin ushqimor dhe trajnimin e të rinjve, që përfshihen në periudhën 3-mujore të praktikës, në kuadër të thirrjes vjetore të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës (PKPP);

p) publikon në fund të vitit kalendarik raportin e veprimtarisë së institucionit dhe në mënyrë periodike raporte për situatën e të rinjve.

5. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKR-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

6. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të punonjësve të AKR-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKR-së.

7. AKR-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, *Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit*, Agjencia Kombëtare e Rinisë”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

8. Vula e AKR-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të AKR-së, sipas këtij vendimi, strukturat aktuale shtetërore për rininë vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

2. Numri i punonjësve dhe buxheti i planifikuar për Shërbimin Kombëtar për Rininë, si dhe të gjitha asetet e tij i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

3. Vendimi nr. 377, datë 11.6.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Shërbimit Kombëtar për Rininë”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe